

**RELACION
PËR
PROJEKTLIGJIN
PËR
KRIJIMIN, MBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E REZERVAVE
MINIMALE TE SIGURISË TË NAFTËS BRUTO DHE
NËNPRODUKTEVE TË SAJ**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN**

Ky ligj përcakton detyrimet për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me naftë bruto dhe nënprodukte të saj në Republikën e Shqipërisë.

Ky ligj siguron bazën për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj. Ai rregullon procedurat e nevojshme për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur deri në mungesë të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto.

Projektligji ka si qëllim krijimin e Agjencisë përgjegjëse për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënprodukte të saj.

Qëllimi i ligjit është siguri i sasisë së produkteve energjetike hidrokarbure, të cilat janë në dispozicion ose nën kontrollin e Këshillit të Ministrave dhe të cilat janë krijuar për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit në vend, për të ruajtur sigurinë kombëtare, për të kryer detyrimet, të pranuar sipas marrëveshjeve ndërkombëtare dhe për të garantuar jetesë normale për popullon.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME
PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE
DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Miratimi i këtij projektligji është i planifikuar në programin analitik të projektakteve të Këshillit të Ministrave (parashikuar në programin e 600 ditëve të dyta).

Ky draft është përpiluar në përputhje me Direktivën 2009/119/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 14 Shtator 2009, “Për vendosjen e detyrimeve

tek Vendet Anëtare për mbajtjen e Rezervës minimale të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj”.

III. PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME TË KËTIJ PROJEKTVENDIMI

Miratimi i këtij projekt akti do të përbëjë një kontribut konkret të Qeverisë Shqiptare për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë së furnizimit me naftë bruto dhe nënproduktet e saj në Republikën e Shqipërisë.

Ligji aktual nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, i cili trajton aktualisht çështjet e rezervës së sigurisë, nuk është në përputhje të plote me Direktivën 2009/119/EC. Gjithashtu ligji aktual vendos të gjithë detyrimin e mbajtjes së rezervës së sigurisë tek industria (shoqëritë e tregtimit me shumicë dhe rafinerite).

Në zbatim të nenit 9, të Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, rafineritë e naftës dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë detyrohen të mbajnë rezervë sigurie për kategoritë e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të VKM nr. 808, datë 05.11.2004 “Për mbajtjen dhe menaxhimin e rezervës së sigurisë për naftën, gazin dhe nënproduktet e tyre”, i ndryshuar, dhe konkretisht për:

- kategorinë 0 (a) naftë brut;
- kategorinë I (a) gazi i lëngshëm i naftës;
- kategorinë II (a, b) benzinë automjetesh, benzinë mjetesh të fluturimit ajror;
- kategorinë III (a, c) gazoil (diesel), lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror, reaktivë, (kerozene);
- kategorinë IV (b) solar.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, përcaktohet se prej vitit 2011, rezerva e sigurisë do të jetë e barabartë me 90 ditë mesatare shitjeje.

Mbështetur në këtë kuadër ligjor vlerësohet edhe sasia e Rezervës së Sigurisë për vitet perkatëse që duhet të mbajnë shoqëritë e tregtimit me shumicë, të licencuara sipas ligjit Nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të përfshira në kategorinë VIII.1, të shtojcës së ligjit, për nënproduktet që ato tregtojnë. Treguesit nxirren

nga përpunimi i të dhënave, të siguruara nëpërmjet korrespondencës zyrtare midis strukturës përgjegjëse në ministrinë përgjegjëse për hidrokarburet dhe shoqërisë përkatëse, në zbatim të Urdhrit të Ministrit nr. 389, dt. 25.11.2014 “Për informacionet dhe të dhënat që duhet të dërgohen nga subjektet që veprojnë në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

Në bazë të Urdhrave të Ministrit, të cilat u janë dërguar shoqërive të tregtimit me shumicë, sasitë e nënprodukteve për detyrimin për mbajtjen e rezervës së sigurisë gjatë vitit 2018, jepen në tabelën, si më poshtë:

	Ton
Naftë bruto	11,903
Benzinë automjetesh	20,706
Gazoil	150,911
Solar	514
Gaz i lëngëzuar i naftës	31,791
Benzinë mjetesh të fluturimit ajror	7
Lëndë djegëse për mjetet e fluturimit ajror	2,538
TOTAL	218,370

Ndërkohë përparësia bazë e projektligjit të propozuar është që parashikon mbajtjen e rezervës së sigurisë nga një Agjenci shtetërore dhe jo nga industria, siç është aktualisht. Arritja e këtij objekti do të realizohet në mënyrë të përshkallëzuar deri në fund të vitit 2022, në mënyrë të tillë që edhe efektet ekonomike që shkakton ky zëvendësim të jenë të pranueshme. Për këtë qëllim, është parashikuar hartimi i një Plani Veprimi, i cili do të detajojë mbajtjen e rezervës së sigurisë deri në fund të vitit 2022, ku industria do mbajë 30 ditë mesatare shitje, ndërsa Agjencia do të ndërtojë në mënyrë graduale pjesën e saj të rezervave. Në këtë mënyrë, do të realizohet një kontroll i plotë mbi rezervën e sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj, si një aspekt shumë strategjik i shtetit shqiptar.

Ashtu sikurse është përcaktuar dhe në dispozitat kalimtare, të projektligjit rezervat e sigurisë të çdo kategori të produkteve energjetike hidrokarbure të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji të mbahen, në çdo kohë, në përputhje me Planin e Veprimit. Deri më 31 dhjetor 2022, operatorët që detyrohen sipas pikës 2 të nenit 9 të Ligjit nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe

tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, duhet të mbajnë rezervë sigurie të barabartë me 30 ditë mesatare shitje në tregun e brendshëm, të veprimtarisë së një viti të mëparshëm. Kjo rezervë sigurie konsiderohet si pjesë e rezervave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Kushtet dhe procedurat e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë të përcaktuara në këtë pikë të bëhen në përputhje me ligjin nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”.

Një përparësi tjetër e këtij projektligji është që parashikon mbajtjen e rezervës së sigurisë për naftën bruto deri në masën 50% të sasisë së rezervës, duke mundësuar kështu jo vetëm mbajtjen e një produkti strategjik që mund të furnizojë rafineritë vendase në kohë mungesash, por dhe uljen e tarifës së rezervës, për shkak të çmimit të ulët në krahasim me nënproduktet e rafinuara.

Gjithashtu, problematika lidhur me identifikimin dhe adoptimin e akteve nënligjore, të cilat janë parashikuar të hartohen në zbatim të këtij projektligji, mbetet një nga pikat më të rëndësishme në kuadër të angazhimeve që ka vendi ynë në dokumentin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë si anëtare e këtij organizmi ndërkombëtar.

Ndër efektet e pritshme është krijimi, mbajtja dhe menaxhimi i rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj në përputhje me praktikën më të mirë europiane, si dhe përdorimi i këtyre rezervave në rast të reduktimit të papritur deri në mungesë të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto.

Me qëllim financimin e krijimit, mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj, është parashikuar dhe vendosja e një tarifë për këtë qëllim. Kjo tarifë do të jetë pjesë e çmimit të karburanteve, e cila do të paguhet nga shoqëritë e tregtimit me shumicë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektakti i propozuar është në përputhje me nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Ky projektakt vjen gjithashtu në përputhje me Direktivën 2009/119/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 Shtator 2009, “Mbi vendosjen e detyrimeve tek Vendet Antare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj” e cila shfuqizon direktivën 73/238/EEC në përputhje me kërkesat e BE.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE*

Ky projekt akt përafuron pjesërisht Direktivën 2009/119/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 14 Shtator 2009, “ Mbi vendosjen e detyrimeve tek Vendet Antare për mbajtjen e rezervës minimale të sigurisë për naftën dhe nënproduktet e saj” për aq sa lidhet me mbajtjen e rezervës së sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektakti përmban 26 nene, me përmbajtje si vijon:

Në **Nenin 1** “Qëllimi” i Projektaktit, përmbahen shpjegimet atë çfarë synon të arrijë ky kuadër ligjor. Si qellim kryesor siguron bazën për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë së naftës dhe nënprodukteve të saj. Ky ligj rregullon procedurat e nevojshme për përdorimin e rezervave të sigurisë në rast të reduktimit të papritur deri në mungesë të furnizimit të tregut me nënprodukte të naftës bruto.

Në **Nenin 2** jepen “Përkufizime” e termave e mëposhtme dhe karakteristikave që ato kanë.

Nëpërmjet **Nenit 3** “Detyrim i ruajtjes së rezervave të sigurisë” Ky ligj ofron bazën për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë për naftën bruto dhe nënproduktet e saj. Rezervat e sigurisë krijohen dhe mbahen për të siguruar furnizim të pandërprerë të tregut me produkte energjetike hidrokarbure.

Në **Nenin 4** “Krijimi i rezervave të sigurisë” Rezerva e sigurisë në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë të paktën 90 ditë e sasive të importeve mesatare ditore neto ose të paktën 61 ditë të mesatares ditore të sasisë të konsumit të brendshëm, cilado nga dy sasi të është më e madhe. Mesatarja ditore e importeve neto llogaritet në bazë të ekuivalencës së naftës bruto të importeve të produkteve energjetikë hidrokarbure gjatë vitit paraardhës kalendarik. Mesatarja ditore e konsumit të brendshëm llogaritet në bazë të ekuivalencës së naftës bruto të produkteve energjetikë hidrokarbure me konsumit të brendshëm gjatë vitit paraardhës kalendarik. Metoda e llogaritjes përcaktohet me udhëzim të ministrit.

Neni 5 “ Përbërja e rezervave të sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” rezervat e sigurisë përbëhen nga produktet energjetike hidrokarbure si në

vijim: a) naftë bruto b) gazoil (diezel) c) benzinë automjetesh d) lende djegëse për mjetet e fluturimit ajror reaktive (kerozene) përveç këtyre produkte kryesore energjetikë mund të përfshihen GLN, GNL, gazi i rafinerisë (jo i lëngshëm), etan, ëhite spirit, benzine avionësh (jet fuel), tipe të tjera kerozene, solar, bitum, vajra lubrifikantë, dyllë parafine dhe koks i naftës.

Neni 6 trajton çështjet e delegimit të rezervave. Rezerva e sigurisë mund të mbulohet pjesërisht nga një marrëveshje me afat të caktuar, ku sipas të cilës një person tjetër juridik merr përsipër detyrimin e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervave të sigurisë dhe fiton të drejtën për të blerë sasi të rezervave të sigurisë të mbuluara nga marrëveshja. Marrëveshja për rezervat e deleguara nënshkruhet midis Agjencisë dhe personit juridik dhe/ose operatorit ekonomik dhe miratohet nga Ministri përgjegjës për hidrokarburet.

Neni 7 përcakton mënyrën e marrjes së të dhënave për llogaritjen e detyrimit të mbajtjes së rezervës të sigurisë. Për llogaritjen e mesatares ditore të importeve neto të produkteve energjetike hidrokarbure të kërkuar, Agjencia merr të dhëna nga Autoriteti Doganor. Për llogaritjen e mesatares ditore të konsumit të brendshëm të produkteve energjetike hidrokarbure të kërkuar, Agjencia merr të dhëna nga institucioni i ngarkuar për hartimin e bilancit energjetik kombëtar. Të dhënat vjetore të kërkuara do të vihen në dispozicion të Agjencisë jo më vonë se data 1 shkurt të çdo viti.

Neni 8 Sasitë që nuk do përfshihen në llogaritjen e rezervave të sigurisë janë produktet energjetike hidrokarbure që nuk llogariten si rezerva të sigurisë janë si më poshtë:

- a) Rezervat që mbahen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në emër të Shteteve të tjera Anëtare të Komunitetit të Energjisë.
- b) Rezervat tregtare të mbajtura nga operatorët ekonomikë, të cilët nuk janë të detyruar të mbajnë pjesë të rezervave të sigurisë si të tilla sipas këtij ligji.
- c) Produktet energjetike hidrokarbure të ruajtura në:
 1. tubacione;
 2. cisternat hekurudhore;
 3. stacionet e shitjes së karburanteve dhe njësive të lëndëve djegëse;
 4. nga konsumatorë të tjerë;
 5. rezervat ushtarake;
 6. anije në det.

Neni 9 Llogaritja e sasisë së rezervave të sigurisë. Agjencia i paraqet Ministrin propozimin për sasinë e rezervave të sigurisë për vitin aktual, jo më vonë se data 1 mars të çdo viti. Propozimi për sasinë e rezervës së sigurisë përcakton: a)

Sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure në ton, që do të miratohen për t'u mbajtur si rezerve sigurie për vitin aktual. b) Struktura e rezervës së sigurisë për vitin aktual. Metodologjia dhe procedurat për llogaritjen e detyrimeve për rezervat e sigurisë përcaktohen me Udhëzim të Ministrit.

Neni 10 përcakton raportimin. Rafineritë e përpunimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj duhet të raportojnë në Agjenci brenda datës 15 të muajit aktual, të dhënat që lidhen me rezervat e sigurisë dhe rezervat tregtare të cilat janë mbajtur gjatë muajit paraardhës. Agjencia mban dhe përditëson vazhdimisht të dhënat e detajuara të të gjitha rezervave të sigurisë të cilat ajo mban dhe të gjitha rezervave të cilat mbahen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Agjencia, para datës 20 shkurt të çdo viti, i paraqet Ministrisë një raport të detajuar të rezervave të sigurisë, në të cilën janë shënuar sasitë, kategoritë e produkteve energjetike hidrokarbure dhe llojet e rezervave të sigurisë të përfshira në regjistrin, deri në ditën e fundit të vitit kalendarik të mëparshëm. Ministria paraqet pranë Këshillit të Ministrave dhe SKE raport të përmbledhur për gjendjen e rezervave të sigurisë para datës 25 Shkurt të çdo viti.

Neni 11 përcakton se krijimi, mbajtja dhe ripërtëritja e rezervave të sigurisë bëhet nga Agjencia duke zbatuar rregullat: a) Plani i veprimit për krijimin e rezervave të sigurisë, b) Vendimi mbi sasinë dhe strukturën e rezervave të sigurisë për vitin e ardhshëm, c) Programi vjetor, duke përfshirë edhe planin financiar për vitin e ardhshëm. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton një plan veprimi për krijimin e rezervave të sigurisë. Plani i veprimit përcakton dispozitat kalimtare për krijimin e rezervës së sigurisë dhe përcakton nivelet minimale në të cilën rezervat e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj të ruhen deri, në fund të çdo viti kalendarik.

Neni 12 Mbajtja e rezervave të sigurisë në territorin e Republikës së Shqipërisë është një prioritet. Por rezervat e sigurisë mund të ruhen jashtë territorit shqiptar në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe / ose nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, në bazë të një marrëveshje paraprake dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe shtetit në të cilin rezervat e detyrueshme të sigurisë duhet të ruhen. Rezervat e sigurisë që janë në pronësi të Shtetit Shqiptar duhet të jenë të siguruara në çdo kohë.

Ndërkohë operatori ekonomik, i cili është subjekti juridik që kryen veprimtarinë e prodhimit, përpunimit dhe tregtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj dhe që ka leje përkatëse të lëshuar nga autoriteti kompetent për një ose disa nga veprimtaritë e mësipërme, do të jete përgjegjës për çdo

humbje të rezervave të sigurisë, për të cilat është titulluar për mbajtjen e tyre dhe dëmeve ndaj të tretëve dhe mjedisit.

Neni 13 “Disponueshmëria e Rezervave”. Rezervat e sigurisë të jenë e disponueshme në çdo kohë, dhe nuk duhet të jenë subjekt i barrës hipotekore, pengut, shtrëngimit dhe konfiskimit. Agjencia dhe Operatorët Ekonomikë duhet të sigurojnë që rezervat e sigurisë duhet të jenë në çdo kohë fizikisht të përdorshme dhe nuk lejohet të transferohen nga mjetet e transportit dhe magazinat e caktuara për mbajtjen e rezervave të sigurisë, pa miratimin paraprak të Agjencisë.

Për të ndihmuar rritjen e sigurisë së furnizimit në vend, në rast krize, rezervat e njohura si "rezerva specifike", të krijuara nëpërmjet miratimit me vendim të Këshillit të Ministrave duhet ti përgjigjen nevojave të vendit. Për këtë qëllim, shteti duhet të ndermarre hapat që rezervat specifike të jenë të përshtatshme dhe të perdoreshme në rast krizash. Nëpërmjet VKM perkatëse vendoset krijimi dhe mbajtja e rezervave specifike, si pjesë e rezervave të sigurisë. Kjo VKM duhet të përfshijë një listë të produkteve energjetike hidrokarbure që do të përdoren për krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike, nivelin e rezervave specifike dhe kohëzgjatjen e detyrimit për të mbajtur rezervat specifike. Krijimi dhe mbajtja e rezervave specifike ka efekt të paktën 1 (një) vit kalendarik.

Neni 14 “Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga magazinimi i rezervave të sigurisë”. Operatorët Ekonomikë, të kontraktuar për ruajtjen e rezervave të sigurisë në magazinën e tyre, janë të detyruar: a) të jenë të pajisur me lejen e duhur për tregtimin me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, b) të mirëmbajnë cilësinë e rezervave të sigurisë në përputhje me rregullat mbi cilësinë e këtyre produkteve në Republikën e Shqipërisë. c) të lejojnë inspektimin pa asnjë lloj pengese të Agjencisë dhe përfaqësuesve të autorizuar të saj. Përfaqësuesit e Agjencisë, në çdo kohë, bëjnë verifikimin e cilësisë dhe sasisë në objektet e magazinimit dhe sigurojnë dokumentacionin e plotë lidhur me rezervat e sigurisë. Agjencia dhe Operatorët Ekonomikë që mbajnë rezervat e sigurisë, janë të detyruar të lejojnë përfaqësuesit e autorizuar nga Ministria për të kontrolluar dokumentet që kanë të bëjnë me rezervat e sigurisë si dhe magazinat dhe vendet ku mbahen rezervat e sigurisë.

Neni 15 “Krijimi i Agjencisë për rezervat e sigurisë të naftës dhe nënprodukteve të saj” Agjencia Shtetërore e Rezervave të Sigurisë të Naftës (ASHRSN) është institucioni përgjegjës për krijimin, mbajtjen dhe menaxhimin e rezervave të sigurisë dhe është i vetmi organ në Republikën e Shqipërisë, i cili është i autorizuar për të blerë, të magazinojë, të menaxhojë dhe të tregtojë rezervat e sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukte të saj, për qëllime të këtij ligji.

Neni 16 “Statusi ligjor i Agjencisë” 1. Agjencia është person juridik publik jofitimprurëse, në varësi të Ministrisë dhe organizohet si Drejtori e Përgjithshme, në nivel qendror me seli në Tiranë.

Neni 17 “Metodat e financimit” Fondet e dedikuara për mbulimin e shpenzimeve për krijimin, ruajtjen, mirëmbajtjen, inspektimin e rezervave të sigurisë, si dhe për aktivitetet e tjera të rregullta të agjencisë, sigurohen nga: a) Tarifatat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë që aplikohen mbi sasitë e produkteve energjetike hidrokarbure, b) Kreditë, c) Të ardhurat nga shitja e rezervave d) Të ardhurat nga shitja e shërbimeve.

Neni 18 “Personat e detyruar për pagesën e tarifës” Tarifatat e krijimit dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë, për detyruesit do arkëtohen nga Autoriteti Doganor gjatë mbledhjes së detyrimit doganor të mallrave me akcizë dhe paguhen në llogarinë e Agjencisë. Paguesit e tarifës së sigurisë janë të detyruar që brenda afatit prej 30 ditësh pas përfundimit të muajit kalendarik në të cilin paguhet pagesa e kësaj tarifë, të dorëzojnë të dhënat në lidhje me pagesën e realizuar pranë Agjencisë.

Neni 19 “Rezervat specifike” Këshilli i Ministrave mund të nxjerrë një vendim me të cilin vendos krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike, si pjesë e rezervave të sigurisë, dhe duhet të përfshijë një listë të produkteve energjetike hidrokarbure që do të përdoren për krijimin dhe mbajtjen e rezervave specifike. Krijimi dhe mbajtja e rezervave specifike ka efekt të paktën 1 (një) vit kalendarik.

Neni 20 “Plani Kombëtar i Reagimit” Në rast të ndërprerjes së furnizimit të tregut me nënproduktet e naftës bruto, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit, merr vendim për përdorimin e rezervave të sigurisë, në përputhje me Planin Kombëtar të Reagimit i cili duhet të përcaktojë elementet: a) Arsyeja për përdorimin e rezervave të sigurisë, b) Afatet për lëvrimin dhe furnizimin për shitje të rezervave të sigurisë, c) Kushtet për përdorimin e rezervave të sigurisë d) Lloji dhe sasia e nënprodukteve të naftës që do të përdoret, e) Veprimet e nevojshme për zëvendësimin e rezervës së sigurisë që do të përdoret Rregullat dhe procedurat e hartimit të Planit Kombëtar të Rregullimit, përfshirë përcaktimin e çmimit të hedhjes në treg dhe mënyrën e përdorimit të rezervave të sigurisë, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 21 “Bashkëpunimi me institucionet përkatëse ndërkombëtare” Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian dhe Sekretariatit e Komitetit të Energjisë. Kjo përfshin të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e furnizimit të produkteve energjetike hidrokarbure në

vendet e Komunitetit të Energjisë ose/dhe ato të BE, si dhe në rastet e vështirësive të mëdha në furnizim dhe çështjet që lidhen me raportimin për gjendjen e rezervave të detyrueshme të Shqipërisë.

Neni 22 “Organet kompetente për zbatimin e monitorimit” Monitorimi për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të marrëveshjeve për depozitimin dhe përtëritjen e rezervave të sigurisë kryhet nga Ministria dhe Agjencia. Gjatë monitorimit, Agjencia në bazë të marrëveshjes, mund të angazhojë dhe persona të tjerë të jashtëm profesionale, fizik ose juridik, nga fushat përkatëse në kryerjen e ndonjë aktiviteti profesional.

Neni 23 Gjobë në shumë prej 7 deri 10 % të të ardhurave totale të vitit fiskal të mëparshëm përfshirë vitin e kryerjes së kundërvajtjes, ose 50% të totalit të të ardhurave të realizuara për një periudhë më të shkurtër të vitit paraardhës të kundërvajtjes. Gjobë në shumë prej 3 deri 7 % të të ardhurave totale të vitit fiskal të mëparshëm përfshirë vitin e kryerjes së kundërvajtjes, ose 50% të totalit të të ardhurave të realizuara për një periudhë më të shkurtër të vitit paraardhës të kundërvajtjes. Përveç gjobës për kundërvajtje, personi juridik i cili ka kryer dy ose më shumë kundërvajtje brenda një viti, mund të vendoset dhe një ndalim i përkohshëm për kryerjen e një aktiviteti të caktuar për një periudhë prej tre deri gjashtë muaj, dhe personit përgjegjës të personit juridik për të njëjtën kundërvajtje. Gjobat e parashikuara në këtë nen jepen nga Agjencia. Të ardhurat e përfituara nga gjobat e vena kalojnë në Buxhet të Shtetit.

Neni 24 “Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare” Rezervat e sigurisë të çdo kategori të produkteve energjetike hidrokarbure të përcaktuar në nenin 5 të këtij ligji të mbahen, në çdo kohë, në përputhje me Planin e Veprimit. Deri më 31 dhjetor 2022, operatorët që detyrohen sipas pikës 2 të neni 9 të Ligjit nr. 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, duhet të mbajnë rezerve sigurie të barabarta me 30 dite mesatare shitje në tregun e brendshëm, të veprimtarisë të një viti të mëparshëm. Kjo rezerve sigurie konsiderohet si pjesë e rezervave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Kushtet dhe procedurat e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë të përcaktuar në këtë pikë të bëhen në përputhje me ligjin 8450, datë 14.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.

Neni 25 - Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11.2, 17.3 dhe 20.4.

Ngarkohet ministria përgjegjëse për hidrokarburet që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4.2, 9, 10.1, 14.6 dhe 24.3.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e projektaktit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia për rezervën e sigurisë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektakti është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Komunitetit të Energjisë në Vjenë.

Për procedim të mëtejshëm, u vijua me marrjen e mendimeve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Mendimet dhe sugjerimet e ministrive janë reflektuar dhe më poshtë informojmë mbi adresimin e tyre në tekstin e relacionit dhe projektligjit:

Lidhur me vlerësimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë:

- Në relacion përshkruhet situata aktuale e llogaritjes dhe mbajtjes së rezervës së sigurisë, referuar legjislacionit në fuqi. Po kështu është sqaruar se si do të mbahen rezervat e sigurisë në periudha të ndryshme, gjithmonë në përputhje me planin e veprimit, deri më 31 dhjetor 2022. Po kështu sipas sugjerimeve të MFE:
 - Do të merret mendimi i Autoritetit të Konkurrencës.
 - Janë riformuluar pikat 1 dhe 2 të nenit 4;
 - Përsa i përket komentit për nenin 6, sqarojmë se Marrëveshja në fjalë është një marrëveshje që nënshkruhet çdo vit kalendarik. Sqarojmë se në nenin 6, janë përcaktuar gjitha elementet që duhet të përmbajë kjo Marrëveshje. Si e tillë, nuk mendojmë se do ishte praktika që marrëveshje të tilla, që mund të jenë disa, të mund të miratohen çdo vit nga Këshilli i Ministrave;
 - Është përfshirë në projektligj në nenin 1 të tij, recitali 8 i preambulës së Direktivës 2009/119/KE;
 - Përsa i përket komentit të MFE për tabelën e përputhshmërisë, sqarojmë se kjo tabelë është bërë dhe është marrë edhe mendimi i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

- Është shtuar dispozita në nenin 8 për mosllogaritjen e “naftës bruto ende të paprodhuar” si rezervë sigurie;
- Përsa i përket komentit mbi nenin 10, lidhur me Administratën Doganore, sqarojmë se është parashikuar mbajtja e rezervës së sigurisë në formën e naftës bruto, pasi vendi ynë është prodhues i naftës bruto, si dhe përpunues i saj, që në kushtet e një mungese të theksuar të furnizimit të tregut mund të përdoret pasi të përpunohet për plotësimin e nevojave të tregut me nënproduktet e saj. Kjo është një qasje e cila do të ulë kostot e nevojshme që konsumatori duhet të paguajë për mbajtjen e rezervës së sigurisë. Lidhur me çështjet e tjera që kanë të bëjnë me administrimin e kësaj sasive, që do jetë për rezervë sigurie në kushtet e ekzistencës së depozitave specifike për naftën bruto, është e mundur të bëhet. Ndërkohë që pika 1 e nenit 18 është riformuluar sipas propozimit të MFE.
- Është shpjeguar në relacionin roli i operatorit ekonomik, si dhe përcaktimet që kanë të bëjnë me rezervën specifike.
- Është bërë ndryshimi në nenin 14, pika 3
- Përsa i përket komentit mbi nenin 16, mbi përjashtimin e zbatimit të akcizave, doganave, taksave të tjera dhe detyrimeve të TVSH, nga ana e MIE vlerësohet që një parashikim i tillë është i domosdoshëm dhe mund të reflektohet komenti i MFE për heqjen nga përmbajtja e nenit 16, në rast angazhimit të MFE për përfshirjen e këtyre parashikimeve në paketën fiskale të propozuar nga institucioni juaj. Ndërkohë në nenin 16, pika 7 jemi të mendimit që duhet të qëndrojë, pasi nuk lidhet me çështje fiskale, por të organizimit të këtij institucioni;
- Lidhur me komentin për ndryshimin e titullit të Kreut IV, ky koment u reflektua;
- Përsa i përket përmbajtjes së nenit 17.1.1 sqarojmë se është parashikuar që fonde të nevojshme për Agjencinë mund të jenë edhe kredi në institucione financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ;
- Lidhur me komentin për përsa i përket përmbajtjes së nenit 24, sqarojmë se janë reflektuar dispozitat konkrete që do të shfuqizohen.

Lidhur me vlerësimin e Ministrisë së Drejtësisë sqarojmë si më poshtë:

- Lidhur me komentin e pikës 2, sqarojmë se shtete të ndryshme kanë ndjekur politika të ndryshme. Ministria përgjegjëse për hartimin e politikave hidrokarbure, pas një vlerësimi të kujdesshëm në bashkëpunimin edhe me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë ka vlerësuar që mënyra më e përshtatshme për Shqipërinë për implemtimin e Direktivës në fjalë është sipas përmbajtjes së këtij projektligji;
- Përsa i përket komentit 3 për produktet që nuk aplikohet akcizë, sqarojmë se ato janë të parashikuara në legjislacionin sektorial fiskal;

- Është bërë saktësimi i nenit 4/3;
- Komenti 5 është marrë në konsideratë dhe është riformuluar fjalia e fundit e pikës 5 të nenit 6;
- Komenti 6 është reflektuar tërësisht;
- Komenti 7 është reflektuar tërësisht;
- Përsa i përket komentit 9, lidhur me mënyrën e përfitimit të tarifave dhe ndikimit në çmimin kundrejt konsumtarëve sqarojmë se këto kosto mund të ndikojë në çmimin e konsumatorit fundor. Kjo duke u nisur nga fakti që koncepti bazë është cdo element sigurie shoqërohet me koston përkatëse. Për më tepër është detyrim i Shqipërisë implementimi i kuadrit ligjor të Komunitetit Europian.
- Komenti 10 dhe 11 është reflektuar tërësisht;
- Komenti 12 është reflektuar tërësisht;
- Përsa i përket komentit 13 sqarojmë se janë reflektuar dispozitat konkrete që do shfuqizohen tek ligji nr. 8450/1999.
- Komenti 14 është reflektuar tërësisht;
- Lidhur me komentin 16, sqarojmë se ky projektligj do i dërgohet edhe këtyre institucioneve për mendim.

Ndërkohë sipas sugjerimeve të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, janë bërë saktësimet në relacion dhe tabelat e përputhshmërisë, sa lidhet me përputhshmërinë në parim dhe në nene të veçanta të projektligjit. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është shprehur në parim dakord me projektligjin dhe relacionin shoqërues të tij.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk realizon të ardhura dhe as shpenzime për buxhetin e shtetit, duke pasur parasysh se të gjitha kostot e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë do të mbulohen nga tarifa që do të vendoset për këtë qëllim.

Në këtë fazë është e pamundur të përllogaritet tarifa e mbajtjes dhe menaxhimit të rezervës së sigurisë, duke pasur parasysh që është subjekt i konjunkturës së çmimeve ndërkombëtare, të cilat nuk janë të parashikueshme.

MINISTRI

Belinda Balluku